MIRASH MARTINOVIQ

BARI I TUFAVE TË YJEVE!

Sot, më 21 korrik, diç pas orës pesëmbëdhjetë më lajmëroi Qazim Muja se në një pyll në periferi të qytetit francez Lodev (ku është dashur të marrë pjesë në Festivalin e poezisë së Mediteranit) është gjetur trupi i pajetë i poetit Ali Podrimja...

PSE SHKOVE NË ATË PYLL

Pse shkove në atë pyll?
Çka kërkoje atje
Tani është e pakuptimtë çdo
Pyetje që bëj. Edhe po të qortoja
E njëjtë është.
Edhe po të bekoja
E njëjtë është

Nëse po kërkoje Lumin nuk kishe nevojë
Të shkoje aq larg. Të futeshe në atë pyll.

Ai mes yjesh është dhe s'duhet
Të merakosesh për të. Edhe ti tani mes yjesh je
Dhe s'duhet më të merakosemi për ty.

Njëherë rrëfeve për ëndrrën e çuditshme
Se Lumi po studionte në Sorbonë
Sikur të kishte ikur nga mendja
Se Lumi yll ishte bërë.

Ndoshta për të kërkoje përrallën
E më të bukurat përralla larg gjenden
Në Pyllin e zi.

Ndoshta kërkoje
Këngën e re, apo ndonjë të vjetër
Kaherë të harruar.

Para disa ditësh më dërgove
Përsiatjet tua mbi Ballkanin dhe Evropën,
KODEKSI ETIK I BALLKANASVE
Kreun e shtatë të këtij kodeksi të pazakontë e përfundon

Me këtë fjali:
Lumi tani do të kishte njëzet e tre vjet. Megjithatë unë gjithnjë vazhdoj të bind Evropën se ai ekziston dhe se diku
gjendet diku në askund.

Më pyete: të pëlqen teksti? Përsëri më thirre dhe përsëri
Më pyete të njëjtën pyetje

Tani dëgjoj fjalët
Zërin tënd mbijetoj ikjen tënde.

Që do të jetojë
Deri në kthimin tënd
Nga ai pyll.

Deri në ardhjen tënde të sërishme
Në ditën e ndritshme.

(16.43)

TANI GJERSA PO PRINTOJ "ÇELËSIN E HUMBUR"

Tani gjersa po printoj "Çelësin e humbur"
Shikoj fotografinë tënde
Në faqen e parë Ti
Me këmishën me katrore dhe
Gishtërinj në mjekër
Dukesh i qetë
Me shikim në peizazhin
E tokës e
Të jetës
E ndoshta në një lule
Në një zog
Në perëndimin diellor
Në Malin e Sharrit
Në gruan që takove në kalim
Njëherë dhe
Kurrë më
Ndoshta në atë fëmijën
Që në kontejnerë mbeturina kërkonte
Për të mbijetuar
Kujt ia dhe librat e Lumit

Për të mësuar në shkollë dhe
Për të mos ardhur më kurrë në
Atë kontejner të mallkuar

Shikimin hedh diku
Ndoshta mbi vete
Apo mbi ne

Shikimin ia hedh jetës
Ndoshta vdekjes

Apo asgjësë

ÇFARË ZJARRESH PO NDEZË

Çfarë zjarresh po ndezë
Çfarë feneri po bartë

Si klerik që
Predikon religjionin e zjarrit
Kërkon rrugën nga terri
Të dalësh po do

Kujt po ia drejton lutjet
Kujt po ia kushton fjalët
Si shkruesi mitik
Po i lë fjalët që
Shndrisin

Mesazhe të fshehta
Që shkruhen

Para fundit

PO TË KËRKOJNË FJALËT E SHKRUARA

Të kërkojnë fjalët e shkruara
Të kërkojnë vjershat
Që i le pa shkruar

Nuk e dijë të mallkojnë

Apo po të bekojnë

Po të kërkojnë ëndrrat
Që pritën t'i bësh
Realitet

Toka do të buzëqeshte
Me buzëqeshjen tënde

Por toka është tokë
Ndoshta e kuptove këtë

Më në fund

ISHE NOTUES I MIRË

Ishe notues i mirë
Kërcyesi më i mirë nga Ura e Gjakovës

Tani je i palëvizshëm

Para dy vjetëve më pate thënë:
Përsëri do të kërcej

Nuk kuptova
Vallë do kërceje
Në lum

Apo në amshim

SI LUFTËTAR ILIR

Si luftëtar ilir
Mbaje heshtën jo për të vrarë
Por vjersha për të shkruar

Çdo vjershë e jotja është plagë e thellë
E shkruar me Heshtë
Në zemrën tënde

Dhe në tokën e Dukagjinit

Njëherë më pate thënë
Duke më rënë fuqishëm kraharorit
Ne luftëtarë të moçëm jemi

Mi the këto fjalë në mëngjesin e 19 korrikut 2011
Para Teatrit Popullor në Prishtinë
Para se të niseshim për Deçan

Të vizitonim varrin e
Poetit Radovan Zogoviq

Atë mëngjes ishe si
Ai fëmija nga Ali Binaku
Që dhimbjen e shndërroi në gëzim
Ferrishtën në lule

Djalosh i përhershëm
Në fund
Shkove në Pyllin e zi

Që
Nga aty ta nxjerrësh diellin

SI TA HARROJ ATË DITË

Si ta harroj atë ditë në
Deçan pranë lumit Bistricë
Që e shikoje i menduar
Si të ishte uji mitik i Letës
Që larg na çonte
Në dete e oqeane ku të gjithë
Do tretemi
Ku do takohemi të gjithë
Më në fund

Atëherë me vetëbesim pate thënë
Poezia do mbijetojë

NUK E PRITE "ÇELËSIN E HUMBUR"

Nuk prite që "Çelësi i humbur" të botohej në Malin e Zi
Vazhdimisht më thirrje, më pyetje: Kur, kur... Kur? Të mungonte durimi
Si gjithmonë. Doje çdo gjë në çast. Poezia dhe vetëm Poezia. Ishin këto
Fjalë gjithmonë në buzët tua në ty. Gjithmonë kisha
Përshtypjen që kokën e kishe përplot fjalë dhe vizione sa donte të plaste.

Të është dashur ta bartësh atë barrë të rëndë dhe të nëmur.

Disa banalitete dhe disa formalitete e shtynë plotësimin e
Dëshirës tënde të madhe
Para disa ditësh ta thashë premtimin e Mlladen Llomparit* –
Se libri yt do të botohet porsa të rridhnin disa para.

Atëherë thoshe se së shpejti do takoje Mlladenin në Francë
Në Festivalin e poezisë, ku do merreshit vesh përfundimisht.

Ja, paratë erdhën. Por ti s'do ta shohësh librin nëse
Nuk ta sjell ndokush që kalon kufijtë e dy botëve.
Me kusht që mos të kthehet. Por për të sjellë dëshirën e paplotësuar.

Me të cilën shkove në Pyllin e zi.

(17.31)
* Mlladen Llompar është poet i njohur dhe kryetar i PEN qendrës malazeze

SHFLETOJ LIBRIN TËND

Shfletoj librin tënd
Dhe sikur shfletoj shekujt.

Shumë poezi janë shkruar
Në Ulpianë.

Sikur t'i kanë pëshpëritur
Zërat e largët antikë

Zërat e ilirëve, trakasve dhe romakëve

Që jetuan në atë
Qytet të largët antik

Banorë i të cilit ishe
Dhe tani je.

Shpirti yt i mirë do mbetet
Në të.
Në Ulpianën tënde dhe timen.

Aty të presësh ata
Ata që do të vijnë.

TANI ISHA
NË NJË LIBRARI TË KËTUSHME

Tani isha në një librari të këtushme
Të lidhi librin tënd, që të fitoj ndjenjën
Se u botua. Ta mbaj në duar.
Ta shikoj.

Isha në dilemë
Në mes kapakëve të zeza apo të kuqe

E kuqja dominoj për shkak të një dere të kuqe
Por të cilën nuk jam i sigurt që e kam parë diku
Më parë do thosha e kam ëndërruar dikur.

Pse kapakë të kuqe dhe pse derë të kuqe?

Ndoshta që nëpër të
Të kalosh më lehtë.

(19.05)

***

Këto fjalë i shkrova për ty, ashtu dhe me atë rend që m'i diktoi dikush. E ndoshta unë ia diktova vetes.

Apo m'i the ti. Nuk jam i sigurt. E dëgjova zërin tënd si jehonte botës. Dhe buzëqeshjen tënde mes yjesh dëgjova. Dhe at thirrjen tënde të shpeshtë:
Poet!

Aq fuqishëm e theksove atë fjalë, at titull të shenjtë. Aq shumë jetove për poezinë. Tërë jetën ia fale asaj.

Vdekja nuk arriti të të prekë asnjëherë.
Aq me shkathtësi e mashtrove, duke u shndërruar në fjalë, e dije
Se ajo përpara fjalëve e pavlerë dhe e pafuqishme është.

Mbrëmë bleva një libër në panairin e këtushëm,
Në qytetin mesdhetar CASTEL NUOVO.
Si të ta jap, e dijë se do të interesonte.
EZRA PAUND. Biografia e këtij poeti të madh
Të cilën e shkroi Çarls Norman.

Por njëjtë, me Paundin do të takohesh, jam i sigurt. Ti je i denjë për këtë shoqëri.

U gjet trupi i pajetë i poetit kosovar Ali Podrimja

Tanjug |21. 07. 2012 – 19:31h | Foto: Ilustrimi | Komente: 2
Qarqet shtetërore franceze kanë bërë me dije ministrin e punëve të jashtme të Kosovës Enver Hoxhaj se është gjetur trupi i pajetë i poetit të njohur kosovar dhe akademikut Ali Podrimja.
Podrimja kishte humbur të gjitha lidhjet me familjen e tij dhe kolegët e miqtë më 18 korrik derisa po qëndronte në Francë dhe merrte pjesë në festivalin "Zëri i Mediteranit" në qytetin Lodev.
Qarqet shtetërore franceze po punojnë në zbardhjen e rrethanave në të cilat Podrimja humbi jetën. Mediat e Prishtinës transmetojnë informacionet se Podrimja kishte vuajtur nga sëmundja e harresës.

P.S. I
Çdonjërin, përfundimisht, e pret lajmi i agjencisë. Ndërsa dikë as lajmi. Ç'është lajmi mbi të gjitha? Aq e parëndësishme është kjo, djalosh. Që u magjepse në lojën e yjeve. Dhe diku fluturove, pa lamtumirë! Ndoshta pas fluturave nëpër pyll. Shkruajnë se

paske vuajtur nga harresa. Ai që në mendjen e vet bart civilizimin, harron për disa banalitete të përditshme.
Ti i mbajte mend të gjitha!
Ty do të mbajnë mend të gjithë!

Castel Nuovo,
21-22 korrik 2012

P.S. II

E çuditshme vdekja jote?...

Sot (më 23 korrik) rreth orës 13 më thirri Jevrem Brkoviqi dhe më njoftoi se të kishin gjetur pesë kilometra nga qyteti Lodev, në një pyll, njëzet metra nga lumi që rridhte atypari. Kishe mbledhur një tufë lule. Kishe vënë lulet dhe të dyja duart nën kokë. Kishe fjetur. Po kur ishe zgjuar kthimi ishte i pamundur, ishe në qiell.
- Kështu flenë barinjtë, me të dyja duart nën kokë – tha Jevremi, probatini yt dhe vëllai i yt në vuajtje, ëndrra, jetë dhe poezi.

Aq çuditshëm ëndërrove, o, ti bari i tufave të yjeve!... Nuk do të të zgjojmë më.

Përktheu nga gjuha malazeze: Qazim Muja